
Re: Kerkese per informacion mbi kapacitetet e depozitave

From info <info@dpm.gov.al>

Date Wed 18/03/2026 15:31

To

Cc

Përshëndetje,

Në përgjigje të e-mailit tuaj, më datë 17.03.2026 “Kërkesë për informacion mbi kapacitetet e depozitave”, ju bëjmë me dije se nga lista e subjekteve të dërguara, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka kryer shërbim për 3 (tre) rezervuarë në subjektin _____ shpk, me NIPT: _____ në adresën e ushtrimit të aktivitetit

Dokumentacioni i lëshuar ndaj subjektit përmban vërtetim dhe certifikatë për secilin rezervuarë, konkretisht:

- certifikata nr. 1, datë 07.11.2024, për rezervuarin _____, me kapacitet 4850 (katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) litra dhe tip: cilindrik, horizontal, nëntokësor;
- certifikata nr. 2, datë 07.11.2024, për rezervuarin _____ Naftë, me kapacitet 10 000 (dhjetë mijë) litra dhe tip: cilindrik, horizontal, nëntokësor;
- certifikata nr. 3, datë 07.11.2024, për rezervuarin _____ Benzinë, me kapacitet 1600 (një mijë e gjashtëqind) litra dhe tip: cilindrik, horizontal, nëntokësor.

Theksojmë se ky dokumentacion është lëshuar bazuar në projektin teknologjik dhe vizatimin teknik të paraqitur nga subjekti, në kushtet e pamundësisë për kryerjen e matjeve, për shkak të gjendjes së rezervuarëve (të mbushur me produkt, pamundësisë për hapjen e tyre dhe vendndodhjes nëntokë).

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, shpreh angazhimin dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për t’ju mbështetur në këtë proces.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,



Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
Autostrada Tiranë-Durrës, km 8